



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 01.12.2022

Nr: 217

Ora: 11:00

VENDIM

PËR

**CAKTIMIN E MASËS SË SHPËRBLIMIT PËR ANËTARËT E KOMISIONEVE ZGJEDHORE NË ZHVILLIMIN
E ZGJEDHJEVE PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, dhe të nenit 29, pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

VENDOS:

1. Të caktojë masën e shpërblimit për anëtarët e komisioneve zgjedhore, si më poshtë vijon:
 - a) Kryetari dhe zëvendëskryetari i Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor (KZAZ), nga momenti i konstituimit deri në shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve shpërblehet:
 - i) Në vlerën 65.000 (gjashtëdhjetë e pesë mijë) lekë, për KZAZ-të të cilat kanë në juridiksionin e tyre më pak se 50 (pesëdhjetë) qendra votimi.
 - ii) Në vlerën 100.000 (njëqind mijë) lekë, për KZAZ-të të cilat kanë në juridiksionin e tyre 50 (pesëdhjetë) deri në 80 (tetëdhjetë) qendra votimi.
 - iii) Në vlerën 120.000 (njëqind e njëzet mijë) lekë, për KZAZ-të të cilat kanë në juridiksionin e tyre më shumë se 80 (tetëdhjetë) qendra votimi.
 - b) Sekretari i KZAZ-së, nga momenti i konstituimit deri në shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve:

Data: 01.12.2022 Nr: 217
Ora: 11:00



“Për caktimin e masës së shpërblimit për anëtarët e komisioneve zgjedhore në zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”

- i) Në vlerën 60.000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë, për KZAZ-të të cilat kanë në juridiksionin e tyre më pak se 50 (pesëdhjetë) qendra votimi.
 - ii) Në vlerën 95.000 (nëntëdhjetë e pesë mijë) lekë, për KZAZ-të të cilat kanë në juridiksionin e tyre 50 (pesëdhjetë) deri në 80 (tetëdhjetë) qendra votimi.
 - iii) Në vlerën 118.000 (njëqind e tetëmbëdhjetë mijë) lekë, për KZAZ-të të cilat kanë në juridiksionin e tyre më shumë se 80 (tetëdhjetë) qendra votimi.
- c) Anëtari i KZAZ-së shpërblehet në vlerën 60.000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë, nga momenti i konstituimit të saj deri në shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve.
- ç) Kryetari i Komisionit të Qendrës së Votimit (KQV) shpërblehet në vlerën 4.000 (katër mijë) lekë.
- d) Anëtari dhe Sekretari i KQV-së shpërblehet në vlerën 3.500 (tre mijë e pesëqind) lekë.
- dh) Anëtari i Grupit të Numërimit të Votave (GNV) shpërblehet në vlerën 6.000 (gjashtë mijë) lekë.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare elektronike të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI